

**THE PHENOMENON OF SENTIMENTALISM IN ALBANIAN PROSE
OF THE 1930-S
DUKURIA E SENTIMENTALIZMIT NË PROZËN SHQIPE TË VITEVE
30-TË**

Artesa OSMANAJ-MAVRAJ¹

^{1*} Phd candidat of Faculty of Philology, University of Prishtina „Hasan Prishtina”

^{*}Corresponding author e-mail: artesa.osmanaj@yahoo.com

Abstract

The paper with the theme „The phenomenon of sentimentalism in the Albanian prose of the 30s” aims to put in the center the values of the prose with a sentimental stylistic orientation, taking into account the history of this prose, the approximate view of the authors and representative works and stylistic tendencies. It was decided for Albanian sentimentalist prose because in the History of Albanian Literature it undoubtedly occupies an important place, and with some exceptions, sentimentalism as a phenomenon has not received enough attention from researchers. Specifically, the phenomenon of sentimentalism in Albanian prose and the masters of Albanian sentimental prose together with their works will be highlighted for examination in a general way.

Key words: *Albanian prose, research, sentimentality, phenomenon, approach, innovation.*

Përmbledhje

Punimi me temë „Dukuria e sentimentalizmit në prozën shqipe të viteve 30-të” synon që të vendosë në qendër vlerat e prozës me orientim stilistik sentimental duke pasur parasysh historinë e kësaj proze, pamjen përsëafërmi të autorëve dhe veprave përfaqësuese dhe prirjeve stilistike. U vendosë për prozën sentimentaliste shqipe sepse në Historinë e Letërsisë Shqipe ajo zë pa dyshim një vend të rëndësishëm dhe me disa përjashtime, sentimentalizmi si dukuri nuk ka pasur vëmendje të madhe sa duhet prej studiuesve. Konkretisht për shqyrtim në mënyrë përgjithësuese do të evidentohet dukuria e sentimentalizmit në prozën shqipe dhe prijtarët e prozës sentimentale shqipe bashkë me veprat e tyre.

Fjalët kyçe: *Proza shqipe, kërkimi, sentimentalizmi, dukuria, qasje, risi.*

Vështrim teoriko-letrar mbi dukurinë e sentimentalizmit

Në letërsinë shqiptare, proza, konkretisht romani me tipare sentimentale-realiste, u zhvillua vonë, atëherë kur në Evropë veçse kishin pasur një paraqitje sentimentalizmi, romantizmi e realizmi. Ndonëse kritika letrare ka qenë paksa e kursyer në vlerësimet apo trajtimet ndaj kësaj proze, prania e individualiteteve krijuese të autorëve, ka qenë evidente dhe një pikë reference për të dëshmuar tiparet e një proze me frymë sentimentale, e cila i trajtonte temat e paprekura të kohës, duke përcjellë jo thjesht mesazhin edukues- didaktik, por edhe atmosferën e kontekstit familjar -shoqëror, ku fshati dhe urbanja i dhanë shkrimtarëve material për trajtimin e temave sociale dhe në qendër u vunë persiatjet zingjirore të sfidave njerëzore nëpër valët e jetës.

Kush ishin këta autorë?, Çfarë idesh e motivesh shfaqën në veprat e tyre ?, Cila është fryma mbizotëruese në krijimet e tyre? Duke u nisur nga parimi i Rene Velekut se ; *“Me rastin e studimit të ndonjë periudhe, lëvizjeje ose të ndonjë letërsie të veçantë kombëtare, studiuesi i letërsisë do të interesohet për lëndën e vet si për diçka të veçantë, të ndarë nga tërësitë e tjera, me karakteristikat dhe veçoritë e posaçme”*,⁴⁵ ne do mundohemi t’i shohim elementet dalluese, të cilat mbizotërojnë si veçori në temat letrare të prozës shqipe të viteve 30 –të .

Në historinë e letërsisë shqiptare, pas vitit 1912, (Shpalljes së Pavarësisë), u hetua një frymë dhe një atmosferë më ndryshe duke i hapur rrugë kultivimit të prozës së mirëfilltë. Edhe pse proza tregimtare kishte shprehje në vitet 1904-1905, konkretisht ndër autorë siç ishte Mihal Grameno i cili shkroi novela, e të cilat shënuan nismën e një lloji të ri letrar, gjinia e prozës mbas vitit 1912, filloi të stabilizohet duke dhënë rezultatet e para të qarta, me një frymë më ndryshe, konkretisht në fillim të vitit 1920-21, me autorë si ; Milto Sotir Gurra, Foqion Postoli, Filip Papajani etj. Sipas studiuesit S. Fetiut ; *“Elementet sentimentaliste zënë fill me romanet e Nikajt, Gramenos, Postolit, për tu ndërthurur me elementet realiste në romanin e Stërmillit, Spasses, Greblleshit”*.⁴⁶

Me shfaqjen e emrave të dalluar të letërsisë, në kultivimin e prozës, u arrit që shprehja letrare të marrë një pamje më ndryshe e një shkëlqim estetik. Duke u nisur nga teoricieni Milivoj Solar që ; *“Çdo vepër letrare i takon kohës së vet dhe prandaj ajo shpreh formë të caktuar të jetës shoqërore të kushtëzuar historikisht”*,⁴⁷ mund të themi që proza letrare në fund të viteve ‘20-ta dhe në vitet e ‘30-ta, ishte përcjellëse artistike e jetës dhe shoqërisë, e cila i rrekte temave sociale me motive të ndryshme e në të cilën lindi burimi i tendencës së re në letërsi, siç ishte sentimentalizmi.

Tonet e sentimentalizmit u thelluan gjithnjë e më tepër, në prozën shqipe, duke u lidhur me problemet e përditshme të njeriut, si reflektim i pabarazisë gjinore dhe plagës sociale që duhej *“çliruar nga pesha që të mund të merrte hov zhvillimi paralel me popujt tjerë të Ballkanit dhe më gjerë”*,⁴⁸ të cilat tone u bënë thelb i prozës letrare shqipe. Kështu, trajtimi i problemeve që nxjerr jeta e vendit, bënë që fryma letrare të gjallërohet me motive e stile të reja. Gjinia e prozës gjeti shprehje te novela, romani dhe tregimi të cilat i bënë jehonë aktualitetit duke e marrë temën nga ndodhitë më të afërta të jetës.

Në këtë prozë, përveç që u shfaq bota subjektive dhe entuziazmi për një jetë më të mirë e dinjitet shoqëror, në qendër kishte ravijëzimin e njeriut të thjeshtë, atij të zakonshmit, saktësisht femrës shqiptare, pozitën e saj të lënë anash në familje dhe në shoqëri. Në një studim për prozën shqipe pas periudhës së Pavarësisë, studiuesi H.Xhaferi konstaton; *“Letërsia shqipe ia doli me sukses t’i gjallërojë dy vlerat karakteristike: ndërtimin e formave dhe përbërjeve të reja letrare dhe formimin e ndjenjës letrare. Ndjenja letrare ka si pjesë përbërëse tiparet estetike të*

⁴⁵ Rene Velek, Ostin Voren, *Teoria e letërsisë*, Onufri, 2015, fq. 33.

⁴⁶ Sadri Fetiut, *Romani shqiptar i luftës*, Rilindja, Prishtinë, 1978, fq. 8.

⁴⁷ Milivoj Solar, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1978, fq. 17.

⁴⁸ Pashënie e romanit, *Sikur t’isha djallë*, Haki Stërmilli, Vatra, Shkup, 2002, nga Dr. Mahmud Hysa, fq. 180.

letërsisë. Ky lloj i artit letrar do të përpiqet që synimet e saj t'i realizonte përmes qëndrimit kritik e jo duke i përjetësuar.⁴⁹

Ndër të tjerash studiuesi shton që në mesin e krijimeve të disa autorëve, si Migjeni e Konica, këto karakteristika vërehen edhe në prozën e Haki Stërmillit. Kështu shkrimtarët u përpoqën të hyjnë në shpirtin e heroit që barte halle e vështirësi nga jeta, duke vënë në pah kultin e ndjenjës, botën subjektive të heroit e cila është ndrydhur nën petkun e mentalitetit të qelbur shqiptar. Sipas studiuesit Rexhep Qosja ; “ *Rrjedhat letrare, si as periudhat historike, nuk qëndrojnë njëra pas tjetrës, por gjithmonë i kanë rrënjët në tjetrën dhe marrdhëniet e tyre s'janë statike, po dinamike, domethënë pohohen dhe mohohen: janë dialektike* ”.⁵⁰

Duke u nisur nga ajo që thotë , studiuesi Qosja, në letërsinë shqiptare midis dy luftimeve gradualisht shihen ndryshime si në pikëpamjen tematike dhe stilistike dhe fillojnë të depërtojnë shkëndija të sentimentalizmit. Duke i dhënë rëndësi dhe kujdes gjendjes shoqërore në përgjithësi dhe gjendjes sociale e njerëzore në veçanti, këto shkëndija përforcoheshin gjithnjë e më shumë, duke bërë që prozat e jetës të bëhen proza letrare.

Mihal Grameno ishte ndër autorët e parë që lëroi prozën shqipe me tri novelat e tij “*Oxhaku* “ (shtypur si nënshkrim në gazetën “*Drita* , 1904-5), “*E puthura*” (1909), dhe “*Varri i pagëzimit*” (1909).⁵¹ Pikërisht me këto novela përveç që nisë një lloj i ri letrar, nisë një frymë e re letrare në të cilën hetohet një dukuri e quajtur sentimentalizëm , e cila zë vend jo vetëm në tematikën e novelave të këtij autori, por edhe në prozën e disa autorëve të tjerë të cilët do t'i përmendim me radhë.

Kështu gjinia e prozës më tutje gjen shprehje te romani, sepse përmes tij rrëfëhet për veten dhe për të tjerët, për jetën dhe shoqërinë, konkretisht te romanet e Foqion Postolit “*Lulja e kujtimit*”, 1920,⁵² “*Për mbrojtjen e atdheut* “, 1921, dhe në fillim të viteve 30 , romani i Sterjo Spasses, “*Nga jeta në jetë-Pse!*”, 1935, romani i Haki Stërmillit , “*Sikur t'isha djalë*, 1936,⁵³ romani i Mustafa Greblleshit , “*Gremina e dashunis*”, 1944 etj.

Sipas studiueses Floresha Dado ; “*Romani është edhe tregues, por edhe rrëfyes, romani trajton raportin universal midis njeriut dhe botës që e rrethon*”.⁵⁴ Edhe pse motivet e gërshetuara , shpesh me ato patriotike përqafonin këto krijime, në thelb të subjektit të tyre, gëlonin tema edukuese të cilat i jepnin letërsisë shqipe fillime të mbara, me një frymë dhe shprehje të veçantë dhe siç thotë studiuesja Sazana Çapriqi “*Romani është një prej zhanreve letrare që i afrohet më shumë se cilido zhanër tjetër, dimensionit social të shoqërisë*”.⁵⁵

Veçori dalluese, hetohen pothuajse te secili shkrimtar, duke filluar me përpjekjet e Mihal Gramenos për t'i shfaqur pakënaqësitë ndaj normave morale të shtresave të larta të shoqërisë, për të poetizuar vlerat shpirtërore të njerëzve të thjeshtë e me zemër të pasur, përmes të cilave autori protestonte për zgjim të ndëgjegjjes shoqërore. Përmes frymës sentimentale që i përshkon tri novelat e tij, u trajtuan tema të ndryshme, të cilat ranë si këmbanë për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të jetës shqiptare.

⁴⁹ SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE, (Materialet e punimeve të Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 13-25 gusht 2012), Hamit Xhaferi, *Zhvillimet e prozës shqipe pas periudhës së Pavarësisë*, fq. 188.

⁵⁰ Rexhep Qosja, *Prej tipologjisë deri te periodizimi*, Akademia E Shkencave Dhe E Arteve E Kosovës, Instituti Albanologjik I Prishtinës, Prishtinë, 1979, fq. 338.

⁵¹ *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, 1989, hartuar nga Vehbi Bala, Razi Brahimi, Klara Kodra, Ali Xhiku, Dhimitër Fullani, Shaban Collaku, nën drejtimin e Dhimitër S. Shuteriqit, fq. 449.

⁵² *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, 1989, hartuar nga Vehbi Bala, Razi Brahimi, Klara Kodra, Ali Xhiku, Dhimitër Fullani, Shaban Collaku, nën drejtimin e Dhimitër S. Shuteriqit, fq. 467.

⁵³ *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, 1989, hartuar nga Vehbi Bala, Razi Brahimi, Klara Kodra, Ali Xhiku, Dhimitër Fullani, Shaban Collaku, nën drejtimin e Dhimitër S. Shuteriqit, fq. 537.

⁵⁴ Floresha Dado, *Teoria e Veprës letrare, Poetika*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 79.

⁵⁵ Sazana Çapriqi, *Romani si kritikë e shoqërisë...*, “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2009, f. 291.

Në vitet e 20-ta , në prozën e Foqion Postolit, konkretisht në dy romanet e tij të përmendura, hetohen gjithashtu dukuri të sentimentalizmit të cilat lidhen me motive e tema të rëndësishme, që ndërtohen mbi realitetin shqiptar me një sërë laramani problemesh. Ndjenjat e ndryshme, sidomos ajo e dashurisë dhe atdhedashurisë, zë vend kyç në prozën e tij, duke ruajtur subjektin me karakter aventuror e sentimentalist. Radhës së shkrimtarëve sentimentalistë i takon edhe Haki Stërmilli, i cili me romanin e tij “Sikur t’isha djalë”, trajtoi çështjen e emancipimit të gruas me përpjekjen që ajo të meritojë vendin e denjë në familje dhe shoqëri. Stili, gjuha dhe forma e shkrimit me frymë sentimentale, bën që ky rrëfim të pasqyrojë më së miri jetën e shoqërisë shqiptare në thelb.

Kësaj tradite të prozës shqipe sentimentale, i takon edhe shkrimtari Sterjo Spasse , veçanërisht me romanin “Nga jeta në jetë-Pse?!”. Sipas studiuesit Vehap Shita : “*Shkrimtari i ri Sterjo Spasse , që vinte në letërsi në rrethana të tjera sociale, nuk u drejtua nga tema historike, as nga ajo patriotike, siç bënë paraardhësit e tij*”.⁵⁶ Kjo nuk do të thotë që autorët e mëparshëm u morën me tema historike e patriotike, përveç disave që gërshetuan temat sociale me ndonjë motive patriotike. Kështu duke qenë me prejardhje fshatare, Spassen e tërheq pasqyrimi i jetës së rëndë të fshatit, emancipimi i shoqërisë, temat etike dhe posaçërisht gjendja e të rinjve intelektualë të viteve 30-të përballë zakoneve patriarkale.

Edhe romani “Gremnia e dashunis”, i autorit Mustafa Greblleshi , që është më i vonë për nga botimi, në vitin 1944, është i ndërtuar sipas skemës së njohur të romaneve-ditar, me tipare të dukshme sentimentale në historinë e rrëfyer për dy të rinjë të dashuruar dhe sipas studiuesit V. Shita ; “*Në stilin e romaneve me nota të shquara snetimentale, romaneve aventuristike e të dashurisë, ku mbizotërojnë ofshamat, sentimentet e nostalgjia, vrasjet apo vetëvrasjet, “Gremnia e dashurisë” është një lloj sinteze e gjithë kësaj, ngjyruar e veshur në petkun shqiptar me ca karakteristika të njerëzve tanë, doke e zakone që e shënojnë ambientin tonë, atmosferën dhe njerëzit t tij*”.⁵⁷

Në përgjithësi, proza e shkruar në roman, novelë apo tregim, kryesisht në vitet e 30-ta, u dallua , posaçërisht me tema sociale , motivin e dashurisë dhe elemente sentimentale. Tiparet stilistike, bartja e emocioneve dhe konflikteve të ndryshme shoqërore, shfaqte në letërsinë shqipe karakteristikat e dukurisë apo fenomenit të sentimentalizmit. Këto romane e novela, pikërisht për frymën që përçonin, tiparet sentimentale, u bënë veprat më të lexuara dhe morën vëmendjen e madhe në atë kohë kur panë dritën e botimit, duke u konsoliduar gjithnjë e më tepër në botimet e atyre viteve.

Kjo risi letrare që u shfaq fuqishëm përmes prozës, do të ndikonte tek lexuesi duke udhëzuar atë për mënyrën se si duhej të ndërtonte një marrëdhënie të re, ndërmjet artit të shkruar dhe realitetit psikologjik dhe shoqëror që po shfaqej në letrat shqipe. Familja, zakonet, atdheu, dashuria, kulti i ndjenjës, roli i femrës, roli i fesë, morali, vetëvrasja, ishin disa nga pikat më qenësore që zinin vend kyç në prozën e autorëve të viteve 30-ta. Theksojmë që shumica e këtyre çështjeve ishin pika vërtet të ndjeshme për vetë autorët që dëshmojnë për një vëmendje serioze që shkrimtarët ua bënë jetës shoqërore të asaj kohe.

Duke iu referuar teoricienit Milivoj Solar që; “*Veprat letrare përmbajnë përvoja dhe dije të caktuara lidhur me shfaqjet e ndryshme natyrore dhe shoqërore, e ato po ashtu drejtpërdrejt flasin mbi jetën shoqërore*”,⁵⁸ kuptojmë që pikërisht veprat letrare të kësaj kohe , ishin pasqyrë e realitetit shoqëror, të cilat me temat sociale, nivelin e lartë të ndjeshmërisë, depërtimet psikologjike që i bënë autori, në përgjithësi me frymën e sentimentalizmit, me tendencën e edukimit, ia dolën të thellojnë këtë pasqyrim, duke iu dhënë hapësirë trajtimit të disa dukurive reale që ishin pjesë e rrethit dhe shoqërisë.

⁵⁶ Vehap Shita, *Gjurmave të letërsisë*, Botimi i dytë, Rilindja, 1980, fq. 177.

⁵⁷ Vehap Shita, *Gjurmave të letërsisë*, Botimi i dytë, Rilindja, 1980, fq. 337.

⁵⁸ Milivoj Solar, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1978, fq. 16

Vepra të tilla, na japin mundësinë për të prekur butësinë e prozës, të marrë në kontekst me jetën dhe shoqërinë shqiptare, ku u morën problematika të mprehta shoqërore dhe u sendërtuan përmes fakturës realiste. Prandaj, duke qenë të një mendimit me konstatimin e teoricienëve e letërsisë Rene Welek dhe Austin Warren që “*është bërë i zakonshëm studimi i veprave letrare si dokumente shoqërore, të nënkuptuara si tablo të realitetit shoqëror*”,⁵⁹ ashtu përceptuam dhe analizuam prozën sentimentale shqipe, e cila është në marrëdhënie të ngushtë me shoqërinë dhe pasqyron kthjellët tablo të saj.

Prandaj, këto vepra i bëjnë të lexueshme padyshim shqiptimi i elementeve si; komunikimi i drejtpërdrejtë me problemet e rëndësishme që e atakuan njeriun, veprimet e tij, jetën dhe shoqërinë në përgjithësi. Vlera e këtyre romaneve lidhet me tema e raste që evidenton drejtpërdrejt praninë e sentimentalizmit. Kështu, duke trajtuar aspekte të veçanta shoqërore-kulturore, autorët në njëfarë mënyre përcaktuan edhe ekzistencën e veprës së tyre letrare.

Shenjat që na tërhoqën vëmendjen janë përmbledhur apo janë të dukshme në gjithë ndërtimin e veprës, (qoftë strukturimi, qoftë skicimi i personazheve, qoftë shpërfaqja e një teme a ideje), duke i dhënë pastaj tone dhe ngjyrë sentimentale. Nuancat në prozën e autorëve janë të dallueshme, prandaj ato lirisht mund të shquhen si tipare të prozës sentimentale shqipe. Përfundimisht nga këto proza mund të shihet se me ç’vërtetësi jetësore shkruajnë autorët e prozës sentimentaliste shqipe, sa thellë depërtojnë në shpirtin e njeriut dhe në problemet, sidomos morale dhe sociale të kohës së tyre.

Referencat

- [1]. Floresha Dado, *Teoria e Veprës letrare, Poetika*, SHBLU, Tiranë, 2003.
- [2]. *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, 1989, hartuar nga Vehbi Bala, Razi Brahimi, Klara Kodra, Ali Xhiku, Dhimitër Fullani, Shaban Collaku, nën drejtimin e Dhimitër S. Shuteriqit.
- [3]. Milivoj Solar, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1978.
- [4]. Pashënie e romanit, *Sikur t’isha djalë*, Haki Stërmilli, Vatra, Shkup, 2002.
- [5]. Rene Velek, Ostin Voren, *Teoria e letërsisë*, Onufri, 2015.
- [6]. Rexhep Qosja, *Prej tipologjisë deri te periodizimi*, Akademia E Shkencave Dhe E Arteve E Kosovës, Instituti Albanologjik I Prishtinës, Prishtinë, 1979.
- [7]. Sadri Fetiu, *Romani shqiptar i luftës*, Rilindja, Prishtinë, 1978.
- [8]. Sazana Çapriqi, *Romani si kritikë e shoqërisë...*, “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2009.
- [9]. SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE, (Materialet e punimeve të Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 13-25 gusht 2012), Hamit Xhaferi, “Zhvillimet e prozës shqipe pas periudhës së Pavarësisë”.
- [10]. Vehap Shita, *Gjurmave të letërsisë*, Botimi i dytë, Rilindja, 1980.

⁵⁹ Rene Wellek, Austin Warren, *Teoria e letërsisë*, përktheu Abdurrahim Myftiu, Onufri, 2015, fq. 103.